

KËRKESË
Nr.1449/3, datë 25.7.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Korçë-Qafë-Plloçë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”” (sipërfaqet m²), si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 (kulturat bujqësore dhe drufrutore) për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikun, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Lidhur me listën ku janë pasqyruar pronarët dhe sipërfaqet (tokë) të cilat preken nga ndërtimi i këtij segmenti rrugor, për pasuritë për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim pranë ZVPP-së”, sqarojmë se nga ZVRPP-të Korçë dhe Pogradec ka të dhëna jo të plota ose jo të qarta. Për këto pasuri do të rikërkohet konfirmimi i titullit të pronësisë pranë këtyre zyrave dhe në bazë të konfirmimit përfundimtar, do të hartohen dhe listat që do të shoqërojnë projektvendimin që do të propozohet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Pronarët për të cilët në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 8 439 003 (tetë milionë e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e tre) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi